



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:210598

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05624736

CAP.nr.923/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Halide Reka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit A.R. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.M., avokat nga Prishtina, ndaj debitorit të përmbarimit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)- me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.1049/21, të datës 19.06.2023, jashtë seance me datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK), me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.1049/21, të datës 19.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar Cpc.nr.1049/21, të datës 19.06.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit Shërbimi Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit Cpc.nr.1049/21 të datës 21.12.2022 mbi caktimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori duke e atakuar të njëjtin, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej

gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje ose të njëjtin ta ndryshoj dhe propozimin për përmbarim ta hedhë poshtë si të pa bazë apo të pasafatshëm.

Përgjigje në ankesën e ushtruar nga debitori, ka paraqitur e kreditori, me të cilën i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të debitorit, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa e debitorit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

*Ankesa e debitorit është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori A.R. nga Prishtina, me datë 17.09.2021, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbarim kundër Shërbimit Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)- me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit përmbarues Vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës 01 Nr.21-962/332 të datës 20.03.2020 .

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me Aktvendimin Cpc.nr.1049/21, të datës 21.12.2022, ka caktuar përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Kundër aktvendimit për përmbarim brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori, duke e kundërshtuar në tërësi aktvendimin për lejimin e përmbarimit, me arsyetimin se propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me nenin 24 paragrafi 5, neni 36 par.1, neni 37 si dhe neni 38 para.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, pasi që akti administrativ në bazë të cilit është kërkuar përmbarimi është nxjerrë në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative duke kontestuar njëkohësisht edhe kompetencën e Inspektoratit të Punës për shqyrtimin e ankesave nga marrëdhënia e punës, me propozim që të aprovohet prapësimi dhe aktvendimi Cpc.nr.1049/21, të datës 21.12.2022 të anulohet ndërsa propozimi për përmbarim të hedhet poshtë si pabazë.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorës me datë 27.01.2023, me të cilën i ka kundërshtuar pretendimet prapësuese të debitorit me arsyetimin se prapësimi i debitorit është formal-juridik duke mos paraqitur asnjë fakt apo provë e cila kishte me arsyetuar kundërshtimin e bërë, andaj si i tillë ky kundërshtim duhet refuzuar si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin e ankimuar Cpc.nr.1049/21, të datës 19.06.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka konstatuar se propozimi për përmbardim është bërë mbi bazën e Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-962/332 të datës 20.03.2020, e që konform nenit 22 të LPP-së, paraqet dokument përmbardues për përmbardim dhe poashtu i përshtatshëm për përmbardim nga se i përmbard të gjitha elementet siç e parasheh dispozita e nenit 27 LPP-së, kreditorin, debitorin, objektin, mjetet e përmbardimit, shumën dhe kohën e përmbardjes së detyrimit.

Gjykata ka shtuar se i ka vlerësuar pretendimet e debitorit përkitazi me kundërshtimin e urdhrin përmbardimor, mirëpo të njëjtat pretendime i refuzoj si të pabazuara me arsyetimin se me asnjë provë nuk është argumentuar e kundërta nga ajo siç është vendosur në dispozitiv të aktvendimit dhe se pretendimet e palës debitore të paraqitura në prapësim nuk paraqesin fakte relevante për të vendosur ndryshe dhe vendimi duhet ekzekutuar ashtu siç është përmbardja e tij. Ka shtuar se i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të palës debitore mirëpo të njëjtat i refuzoi si të pabazuara me arsyetimin se sipas nenit 24 par.5 të LPP-së përmbardimi caktohet dhe ndaj vendimit të dhënë në procedurë administrative apo gjyqësore që nuk është përfundimtar vetëm po qesë me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera nuk e ndalojnë përmbardimin dhe që në rastin konkret me Ligjin për Inspektoratin e Punës nenit 6.4 të Ligjit nr.2002/9 dhe 03/L-017, është paraparë që ankesa e ushtruar ndaj vendimit të Inspektoratit të Punës nuk e shtyn ekzekutimin andaj, bazuar në këto dispozita ligjore me të drejtë mbi bazën e dokumentit të lëshuar në procedurë administrative është lejuar përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla ende pa u bërë i formës së prerë sepse ankesa nuk e ndal ekzekutimin e tij. Në fund ka shtuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se debitori i përmbardimit nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbardur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbardimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbardimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbardimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK-së dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i lëshuar nga Inspektorati i Punës 01 Nr.21-962/332 të datës 20.03.2020 në rastin konkret është dokument përmbardues, kjo parashihet me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së e cila dispozitë përcakton se: “*Dokument përmbardues është edhe vendimi përmbardues i dhënë në procedurë administrative*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbardimit sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se: “*Organi përmbardues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbardimin vetëm në*

*bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, e po ashtu i plotëson kushtet nga neni 24 paragrafi 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: “Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”, e po ashtu i përmban kërkesat nga neni 27 paragrafi 1 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, andaj edhe pretendimet e të autorizuarit të debitorës se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.*

Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë çështje juridike përmbarimore përmbarimi është lejuar në bazë të vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-962/332 të datës 20.03.2020, i cili i plotëson kushtet për përmbarim dhe është i përshtatshëm për përmbarim, bazuar në dispozitën e nenit 6.4 të Ligjit nr.2002/9 dhe 03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovës sipas së cilës dispozitë ankesa e ushtruar kundër vendimit të Inspektorit të Punës nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit dhe dispozitën e nenit 144 par.1 pika 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilën përcaktohet se : “një akt bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës me aktin, kur sipas ligjit ankesa nuk ka efekt pezullues”. Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, andaj kjo gjykatë vendosi që aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetojë dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pa bazuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitën e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK- së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.923/2023, me datën 23.04.2024

Gjyqtarja,  
Halide Reka d.v